



SHTEGU I MONUMENTEVE KULTURORE NË PEJË

PEJA CULTURAL HERITAGE TRAIL

Qendra e Qytetit / City Center

Shtegu kulturor fillon nga qendra e qytetit, ku në anën perendimore gjendet hoteli i parë i ndërtuar në vitin 1928, e nga ku mund t'i shihni edhe bukuritë e bjeshkëve të Rugovës, ndërsa në anën veriore gjendet memoriali i demonstratave të vitit 1968. Shtegu vazhdon nga ana lindore përgjatë hotelit „Dukagjini” i ndërtuar në vitin 1956. Në anën lindore të qytetit, shtegu vazhdon të arrijë në sheshin "Haxhi Zeka", ku gjendet përmendorja e patriotit Pejan. Ndërsa nga aty, në anën e majtë gjendet muzeu etnografik apo konaku i Tahir Beut.

The cultural trail begins in the center of the town, where in the west you will find the first built hotel in 1928, and from where you may also see the beauty of Rugova Mountains. On the north side you may see the 1968 Demonstration memorial. The trail continues along the east side by hotel Dukagjini built in 1956. On the eastern side of the city, the trail continues reaching "Haxhi Zeka" square, where Haxhi Zeka statue is located. You may find the Museum of Peja (Tahir Beu Inn) on your left.

Konaku Tahir Beut / Tahir Beu Inn



Konaku i Tahir Beut paraqet llojin më të bukur të shtëpive të vjetra të qytetit. Kjo shtëpi e ndërtuar në vitin 1800 është nën mbrojtjen e monumenteve. Këtë lloj ndërtimi e karakterizojnë kurora e kulmit e punuar nga druri, dritaret harmonike dhe divanhania e sipërme. Konaku gjendet në sheshin "Haxhi Zeka", ku janë të ekspozuara artizanatet dhe veshjet karakteristike të Pejës, Rugovës dhe Rrafshit të Dukagjinit.

Tahir Beu Inn represents the most beautiful type of houses in Peja. This house is a cultural monument built by Albanian masters in 1800. The building was first located in the town center (between the municipality and a postoffice), and in 1960 it was honored by being re-located in the Haxhi Zeka square. This ancient house has its architectural composition and spatial structure and functional overlap with the compositional features of many medieval houses in Peja. This type of buildings is characterized by wooden roof crowns, wooden fordable windows and upper wooden balcony know as "divahane".

Çarshija e vjetër e Pejës / Peja old bazaar



Në të majtë të përmendores "Haxhi Zeka" gjendet hyrja për "Çarshinë e vjetër", e cila paraqet një zonë me trashëgimi kulturore dhe historike. Çarshia e Vjetër është e njohur për rëndësinë e saj në zhvillimin ekonomik. Kjo zonë është ndërtuar gjatë kohës së Perandorisë Osmane në shek. XIV dhe përbëhet nga 4 pjesë (Çarshia e Madhe, Çarshia e Gjatë, Okoli dhe Çarshia e Shtatëvinit). Asokohe në Çarshi gjindeshin rreth 960 dyqane ku janë përpunuar zeje të ndryshme. Edhe sot, në Çarshi ende ekzistojnë disa nga këto dyqane të cilët shfrytëzohen për qëllime të njejta.

Old Bazaar area is part of the Cultural Trail. It is known for its importance and impact in the economic development of the city and the whole region, thus it represents an important heritage value of the city. The Bazaar was built during the Ottoman empire era - in the XIVth century and was then composed of four parts: Great Bazaar, Long Bazaar, Okol and Fountain Bazaar. Back then, there were around 960 shoppers selling different crafts. Even today, you may find some of these artisan shops that carry on with their traditional craft activities.

Bajrakli Xhamia / mosque



Në mes të Çarshisë së vjetër gjendet "Bajrakli Xhamia" ose siç njihet edhe në popull me emrin "Çarshi Xhamia". Kjo xhami unike në stilin e saj është ndërtuar në vitin 1471. Përveç arkitekturës ndërtimore, karakteristike e kësaj xhamie është edhe stilizimi i mureve në kupolat e saj.

In the center of the Old Bazaar, you may find the old mosque know as "Bajrakli Mosque" or "Bazaar Mosque". This unique mosque was built in 1471. Besides its architecture, other characteristics such as cupolas and domes' styling make this mosque one of its kind.

Hamami haxhi Beut / Haxhi Beu Hammam



Hamami i Haxhi Beut është poashtu një nga objektet me vlera të larta kulturore, i cili është i përfshirë në shtegun kulturor të qytetit të Pejës. Është objekt i ndërtuar në shek. XV, në kohën e Perandorisë Osmane i cili asokohe është shfrytëzuar nga qytetarët si banjë publike. Ka një histori mjaftë të hidhur, pasi që shumë herë është tentuar që këtij objekti t'i zhduken gjurmët. Afër Hamamit gjendet edhe shkolla e parë shqipe në qytetin e Pejës, ndërtuar nga Haxhi Zeka, e njohur si "Shkolla e Vogël".

Haxhi Beu Hammam is an important building with high cultural values for the city, which is part of the cultural trail. This building was built in the XV century during the Ottoman Empire, and back then was used by citizens as a public bath. This Hammam has a bitter history for the fact that there were several attempts by people to eradicate the building. However, due to citizens' engagement and contribution, the building was protected, maintained, and nowadays it is being used for hosting many exhibitions. Close to this hammam, you may find the first school in Peja known as "Small School" which was built by Haxhi Zeka.

Defterdar dhe Kurshumli xhamia / Defterdar & Kurshumli mosque



Shtegu vazhdon me vizitën e xhamisë më të vjetër në qytet - "Teftedarit", e cila është djegur në luftë ndërsa është restauruar disa vite më parë. Sot ajo gjendet në listën e objekteve të mbrojtura me ligj. Jo shumë larg nga kjo xhami gjendet "Kurshumli Xhamia" e ndërtuar në shekullin XV e që vlerësohet si njëra nga xhamitë më të bukura në qytet, ku gjatë restaurimit të saj janë gjetur themelet e saj të vjetra.

The trail continues with a visit at the oldest mosque in Peja, know as "Teftedar Mosque", which was burned during the war in 1999 and was restaurated some years ago. Today, it is on the cultural heritage list. Not far away from there, you can visit another mosque built in the XV century known as "Kurshumli Mosque". It is one of the most beautiful mosques in the city and during its restoration, its old basements were found.



Mulliri "Haxhi Zekës" / Mill of "Haxhi Zeka"

Shtegu vazhdon me vizitën e Kompleksit "Mulliri i Haxhi Zekës" si mulliri i parë industrial me ujë. Mulliri është restauruar dhe është nën mbrojtje ndërsa shërben për vizita të ndryshme kulturore. Në objektin e hambarit është e vendosur qendra për zhvillimin e artizanateve.

The next stop of the trail is a visit at the "Haxhi Zeka Mill" which is know to be the first industrial mill with water supply and afterwards with electricity. This historical complex was burned several times with the aim to loose the roots of its importance. A center for the development of artisans is set on the other building next to the mill, known as "Hambar".

Kullat e Pejës / Peja towers



Kullat janë shtëpi unike të ndërtuara nga gurri i gdhendur dhe të ilustruara me punime artistike si në pjesën e jashtme gjithashtu edhe në brendin e saj. Kullat janë vepër unike e rafshit të Dukagjinit të cilat janë ndërtuar me mjaft profesionalizem nga mjeshtrit e gurit të asaj kohe dhe të cilët kanë arritë të zhvillojnë një kompozicion unik për shfrytëzimin e tërsisë së saj për nevoja të ndryshme të familjes. I takojnë shekullit të XVIII-XIX ndërsa Peja veçohet për ndërtimet unike të tyre. Kryesisht kanë qenë dy ose tri katëshe dhe secili katë ka pasur funksionin e sajë. Zakonisht kati i parë përdorej si depo apo ahur i bagëtive, i dyti për banim ndërsa kati i tretë përdorej si odë për pritjen e burrave. Në Pejë ka pasur më shumë se 100 kulla por shumica e tyre tani nuk ekzistojnë për shkak të zhvillimeve kohore por edhe nga shkatërimet që u bënë gjatë luftës së fundit të vitit 1999. Por disa ekzistojnë ende dhe vizitorët mund t'i shikojnë ato dhe të marrin eksperiencat e zhvillimit të Pejës. Kulla e Qamil Limani (e njohur gjithashtu si kulla e Kahreman Agës), Kulla e Goskajve, Kulla e Zenel Beut dhe kulla e Jashar Pashës janë shembujt që mund t'i shihni gjatë shtegimit tuaj në shtegun kulturor.

The towers (kulla) are unique houses built of carved stone and illustrated with works of art both on the outside and inside part of it. The towers are a unique work of the Dukagjini plain which were built with great professionalism by the stone masters of that time and who have managed to develop a unique composition for the use of its entirety for different needs of the family. They belong to the XVIII-XIX century while Peja stands out for their unique constructions. There were mainly two or three floors and each floor had its own function. Usually, the first floor was used as a warehouse or cattle barn, the second floor for living while the third floor was used as a waiting room for men. There were more than 100 towers in Peja but most of them now do not exist due to time developments but also due to the destruction that took place during the last war of 1999. But examples still exist and visitors can see them and get experiences of Peja development. The Tower of Qamil Limani (known also Kahreman Aga tower), tower of Goska, tower of Zenel Bey and Jashar Pasha tower are examples that you can see during your trip to the cultural path.



Varezat Austro-Hungareze / Austro-Hungarian cemetery



Varrezat Austro-Hungareze janë varreza të hershme të viteve 1900-1912. Këtu gjenden të varrosur trupat e ushtarëve Austro-Hungarez të cilët kanë shërbyer në atë kohë në Pejë prej nga e marrin edhe emrin e tyre.

Austro-Hungarian Cemetery - belong to the years 1900-1912. In these graves there are hundreds of Peja's citizens buried Austro-Hungarian soldiers' graves that have served in that time in Peja. Even though no further research related to this cemetery has been made, it is expected that in the near future there will be more information found on these graves.

Kisha Shën Katarina / St. Catherine church



Shtegu vazhdon me vizitën e kishës katolike "Shën Katarina" e ndërtuar mbi themelet e një kisha më të vjetër të konfesionit katolik-shqiptar në vitin 1928. Si famulli, kisha e "Shën Katarines" ekziston që nga koncilli i parë i Arbërit (viti 1703 i udhëhequr nga Papa Klementi). Kisha është e tipit bazilikë me tri anijata.

Another cultural monument is the catholic church "St. Cathrine", built in the basement of an older catholic church from 1928. As a parish church, "St. Cathrine" exists from the Arber's first Council (year 1703 lead by pope Clemente). The church is a three-nave basilica type

Patrikana e Pejës / Patriarchate of Peja



Shtegu kulturor vazhdon me vizitën e kishës ortodokse e njohur si "Patrikana e Pejës", e ndërtuar në shek.XIII e cila gjendet në hyrje të Grykës së Rugovës. Është një nga monumentet më të rëndësishme të periudhës së vonshme Bizantine në Europë. Të katër ndërtesat e objektit reflektojnë me kulturën e lartë kishtarë bizantino-romake me një stil të veçantë të pikturave murale.


The cultural trail continues with a visit of the orthodox church "Patriarchate of Peja", which belongs to the XIII century. This wellknown church is located in the entrance of Rugova Canyon. It is one of the most important monuments from the late Byzantine era. The four buildings reflect the ancient Roman-Byzantium culture of a particular style of wall paintings and its frescoes.



Republika e Kosovës
Ministria për Kulturë Rini dhe Sport



+383 (0) 44 278 809
+381 (0) 39 421 398
pejawwc@yahoo.com
www.qmg-ks.org



- | | |
|--|--|
| 1 Qendra qytetit
City Center | 8 Kompleksi historik " Mulliri Haxhi Zeka"
Historical complex "Mill of Haxhi Zeka" |
| 2 Konaku i Tahir Beut (muzeu)
Tahir Beu Inn (Museum) | 9 Kulla e Qamil Limanit (Kahraman Agës)
Qamil Limani Tower (Kahraman Aga) |
| 3 Çarshija e Vjetër
Old Bazaar | 10 Kulla e Gocka-jve
Gocka Tower |
| 4 Bajrakli xhamia
Bajrakli mosque | 11 Kulla e Zenel Beut
Zenel Beu Tower |
| 5 Hamami i Haxhi Beut
Haxhi Beu Hammam | 12 Varezat Austro-Hungareze
Austro-Hungarian cemetery |
| 6 Defterdar xhamia
Defterdar mosque | 13 Kisha Katolike "Shën Katarina"
"St. Catherine" Catholic Church |
| 7 Kurshumli xhamia
Kurshumli mosque | 14 Patrikana e Pejës
Patriarchate of Peja |